Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**25.08.2023**	**08.09.2023**	**2023/0608**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.08.2023, OE "STORM ICT L.L.C."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0608, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "STORM ICT L.L.C."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Digjitalizimi i sherbimit te urgjences" me nr. të prokurimit: "622-23-5379-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0608 i dt:22.08.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Pas pranimit te Njoftimit mbi vendimin e AK-se, ne arsyet e cekura nga AK qe ne Grupi i

Operatoreve Ekonomik: Storm ICT L.L.C & Safebit L.L.C jemi eleminuar pasi qe

mungojne:

1. Mungojne staf te certifikuar ne a) MCSA b_ MCSE c) MCTS d) Certificate Storage e) Certificate Desktop and Workstation Repair.

2. Mungojne Autorizimet nga prodhuesi ose dileri i autorizuar per shitje dhe servisim - origjinal apo te noterizuar per pikat 1,2,3,4,5,6,7,8.

Ne Grupi i Operatoreve Ekonomik: Storm ICT L.L.C & Safebit L.L.C konfirmojme qe dokumentet qe pretendohet nga AK se nuk jane dorezuar, i kemi dorezuar ne oferten tone. Gjithashtu pas kerkeses sone per qasje ne dokumentacion dhe pas pranimit to ofertave ne lidhje me kete aktivitet te prokurim kemi konfirmuar edhe nje here se dokumentet qe pretendohet nga AK qe nuk i kemi dorezuar, jane te dorezuara ne oferten tone. Po ashtu kemi hasur se operatori ekonomik i cili rekomandohet nga AK te shpallet fitues mungojne dokumentet si me poshte:

1. Operatori Ekonomik qe rekomandohet te shpallet fitues ne oferten e tyre nuk kane staf te certifikuar per MCSA dhe MCSE si dhe mungojne certifkatat per keto 2 pika.

2. Autorizimi nga Distributori AP FLYER qe autorizon operatorin ekonomik qe rekomandohet fitues nga AK per MILBOOK, nuk eshte i nenshkruar as i vulosur nga personi pergjegjes i distributorit si dhe sipas Kerkeses mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale qe kerkohet Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim - origjinali apo të (Noterizuar), autorizimi ne fjale nuk eshte i noterizuar.

Kerkojme qe lenda e ketij aktiviteti te prokurimit te kthehet ne ri-vleresim.

KRITERET PËR VLERËSIM

Dëshmia 2. (a,b,c,d,e) Diploma, Certifikata, Kontrata e punës me ofertuesin (origjinal, në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë). Personali duhet te kete certifikimet • MCSA(Microsoft Certified System Administrator), • MCSE(Microsoft Certified System Engineer), • MCTS(Microsoft Certified Technology Specialist) • Certificate Product technology Storage • Certificate Product Desktop and Workstation Repair Issues

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

LISTA E VLERËSIMIT TË OFERTAVE

TITU Digjitalizimi i shërbimit të Urgjencës

NR. I 622-23-5379-111

DATA : 19/07/2023

NR	EMRI I OPERATORIT EKONOMIK	Deklerat nen betim	Crtif. e bis.+nr.fiskal	Certifikata E TVSH	Qarkullimi	Referencat	Mesatarë Projektit	Lista e punëtorëve	Raisi	FATHQOJET	SIGTENDERIT	AUTO ALINET	HOST	HCSE	HCJS	CERT. SOURCE	CERTIFIKATA TË FISKUT	CERTIFIKATA E PUNËS	Verejtje
1	PANAMIC ICT	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	
2	GO STORM ICT & SAFEBIT	+/-	+/-	+/-	+	+	+	+	-	+	-	-	-	-	-	-	+		
3																			
4																			
5																			
6																			
7																			
8																			
9																			
10																			
11																			
12																			
13																			
14																			
15																			

Me kontrat ~~e~~ propozohet OE PANAMIC ICT, me çmimin 134.715.00.

Anëtaret e komisionit :

1. Dr. Gyzmo Ahmeti
2. Arbër Bajgora
3. Bahtiu Hoxha

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **STORM ICT L.L.C.**

Pretendimi nr.1

Pretendimi i parë ankimorë ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së(komisionit vlerësues) të nëjtit OE i mungojnë :

"Mungojnë nga OE Consortium STORM ICT L.L.C.; Safebit L.L.C.-dëshmojë qe ka staff te certifikuar ne a) MCSA b) MCSE c) MCTS d) Certificate Storage e) Certificate Desktop and Ëorkstaion Repair"

OE ankues pretnedon se të gjitha këto dokumente gjenden ne ofertën e tij, megjithatë OE ankues në ankesë nuk potencon ne mënyrë decidive se cilat janë ato certifikata, në emër të kujt janë , qfar numri mbajnë apo ndonjë informatë tjetër konkrete.

Megjithkëtë pas analizimit të ofertës së OE ankues, kemi gjetur se i njëjti i plotëson kërkesat për certifikata MCSA, MCSE dhe MCTS.

Konkretisht OE ka ofruar dëshmi certifikatat MCSA, MCSE dhe MCTS për z.Muhamet Gërxhaliu.

Po ashtu për z.Alban Beqiri OE ka preznatuar certifikata MCSA dhe MCSE.

Ndërsa për pikat ***d) Certificate Storage e) Certificate Desktop and Ëorkstaion Repair*** thesopjmë se as OE ankues e as AK nuk kanë dhënë sqarime të mëtutjeshme, se pse OE ankues plotëson apo nuk i plotëson të njëjtat.

OE ankues në ofertën e tij si për dy punëtoret e cekur më lar po ashtu ka edhe punëtor tjerë me certifikata tjera të cilat mund të jenë në pajtim me kërkesat e AK-së, megjithëkëtë OE nuk ka dhënë sqarime të mëtutjeshme në ankesë.

Bazuar në këto që u cekën më lart, në parim vlerësojmë se pretendimi ankimorë është i bazuar pasi certifikatat kryesore për të cilat është eliminuar, kemi gjetur se i njëjti i plotëson, ndërsa për dy certifikatat e fundit D dhe E, vlerësojmë se mund të sqarohen gjatë rivlerësimit eventual nw pajtim me nenin 72 par.3 te LPP.

Pretendimi nr.2

Pretendimi i dytë i OE ankues po ashtu ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues ku sipas AK-së:

"Mungojnë nga OE Consortium STORM ICT L.L.C.; Safebit L.L.C.-dëshmojëAutorizimet nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim - origjinali apo të (Noterizuar) (për pikat 1,2,3,4,5,6,7,8)".

OE ankues pretnedon se gjitha këto dokumente gjenden në ofertën e tij, megjithëkëtë sikurse në pretendimi nr.1, OE ankues nuk jep sqarime më mëtutjeshme se cilat janë ato autorizime, nga cili prodhues, për cilin pordukt etj. Sqarime të mëtutjeshme në këtë pikë nuk ka dhënë as AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim, ndërsa OE ankues ka ofruar një numër

të autorizimeve. andaj vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar dhe rekomandojmë që me rastin e rivlerësimit OE ankues të jetë konkret, dhe ti ofroj sqarime për AK-në cili autorizim për cilin produkt është ofruar

Pretendimi nr.3

OE ankues po ashtu pretendon se OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm pasi i nëjjti :

1. Operatori Ekonomik qe rekomandohet te shpallet fitues ne oferten e tyre nuk kane staf te certifikuar per MCSA dhe MCSE si dhe mungojne certifkatat per keto 2 pika.

2. Autorizimi nga Distributori AP FLYER qe autorizon operatorin ekonomik qe rekomandohet fitues nga AK per MILBOOK, nuk eshte i nenshkruar as i vulosur nga personi pergjegjes i distributorit si dhe sipas Kerkeses mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale qe kerkohet Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar për shitje dhe servisim - origjinali apo të (Noterizuar), autorizimi ne fjale nuk eshte i noterizuar.

Pas analizimit të vendimit të AK-së në kërkesë për rishqyrtim, nuk kemi gjetur se AK janë përgjigjur në këtë pretendim ankimorë fare. Nga analiza ofertës së OE të rekomanduar nuk kemi gjetur se i njëjti ka ofruar dëshmi për certifikatat MCSA dhe MCSE. Ndërsa autorizimi i kontestuar vërtet nuk mban nënshkrim, megjithatë mbanë emrin e Drejtorit të shitjes dhe të gjitha të dhënat kontaktuese të kompanisë, përmes cilave AK mund të kërkoj sqarim/konfirmim.

Pasi AK nuk ka ofruar përgjigje në këtë pretendim ankimorë, vlerësojmë se edhe për OE të rekomanduar (njëjt sikurse për OE ankues) AK mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me këto certifikata dhe autorizime, mirëpo gjithnjë duke pas parasyshë që sqarimet/plotësimet të kërkohen vetëm për dokumente me datë të fiksuar para hapjes së ofertave e që mund të verifikohen në mënyrë objektive, në pajtim me dsispozitat e LPP-së nenit 72 par.3.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar janë pjesërisht të bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesersith e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **STORM ICT L.L.C.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA